







III.3 VEPRAT EKZISTUESE TE ARTIT:

Rruga Tirane – Ndroq – Plepa eshte rruge nacionale e ndertuar shume vite me pare . Duke gjykuar nga koha qe eshte ndertuar edhe veprat e artit ne kete rruge jane deshmi e teknologjise dhe mundesive konkrete te ndertimit te urave ne ate kohe.

Strukturat e urave jane ndertuar kryesisht me betone masive , pra dominojne urat qemere betoni me nenstruktura me mure prej guri ose betoni .

Themelet e urave te pilave dhe ballnave jane themele masive . Ne veprat e artit ekzistuese verehen nderhyrje me riparime te ndryshme gjate kohes se shfrytezimit ne drejtim te permiresimit te elementeve te ndryshem te ures ne nenstruktura e mbistruktura .

Ne te gjitha urat vihet nje ngritje e shtresave asfaltike deri ne nivelin e trotuareve si pasoje e mbivendosjes se shtresave asfaltike te reja pa bere skarifikimin e shtresave ekzistuese.

Ura e Beshirit mbi lumin Erzen

